

**OPERATORI I SISTEMIT TE TRANSMETIMIT
DEPARTAMENTI I TREGUT
DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË TREGUT**

Nr. 5359 prot.

Tiranë, më 02.08/2022

Lënda: Kërkesë për zgjatjen e periudhës së parashikuar në pikën 2 të Vendimit të ERE Nr.78, datë 13.04.2022.

ENTIT RREGULLATOR TE ENERGJISE
Blvd. “Bajram Curri”, Rruga “Viktor Eftimiu”, nr. 1023, Tirane

I nderuar Z. Ahmeti,

Në vijim të komunikimeve të deritanishme në lidhje me zgjatjen e periudhës së parashikuar në pikën 5 të Vendimit të ERE Nr.255, datë 21.12.2021. Dhe në zbatim të Vendimit të ERE Nr.78, datë 13.04.2022, ku shprehet zgjatja e periudhës kohore të proceseve të tregut balancues me rezolucion orar deri në 30.09.2022.

Ju bejmë me dije se, Komiteti përgjegjës i ngritur për rishikimin e rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, të miratuara me vendimin e ERE nr. 106, datë 02.07.2020, është në proces vlerësimi të gjithë skenarëve me qëllim që të kemi një rishikim gjithëpërfshirës të rregullave. Pjesë përbërëse e procedurës është dhe rishikimi i intervalit kohor prej 15 minutash në proceset e tregut të balancimit, ku përfshihen nominimet, llogaritjet respektive të disbalancave dhe selektimi i rezolucioneve kohore të konfigurimit të proceseve. Gjithashtu, OST është në proces të implementimit në platformën elektronike të Menaxhimit të Tregut, të specifikimeve të hartuara konform rregullave në fuqi në të cilat përfshihen dhe kërkesat që lindin si pasojë e diversifikimit të burimeve të rinovueshme dhe integrimi i tyre në tregun balancues. Si dhe implementimi i procesit Imbalance Netting me vendet fqinje në mënyrë të tillë që të minimizimin e kostove të disbalancave në interkonjeksion.

Në këto kushte, OST vlerëson që nevojitet një periudhë më e gjatë për ta finalizuar këtë proces të rëndësishëm për operimin e tregut balancues.

OST kërkon mirëkuptimin tuaj për miratimin e zgjatjes së periudhës së parashikuar në pikën 2 të Vendimit të ERE Nr.78, datë 13.04.2022 deri në datën 31 Dhjetor 2022.

Mbetemi të hapur për çdo sqarim të mëtejshëm, duke shpresuar se propozimi ynë do të merret në konsideratë prej jush.

Me respekt,

ADMINISTRATORI I OST SH.A.



OST
SISTEMI TE TRANSMETIMIT
Skerdi Drenova